

Z. Klarenc Xhaferaj ka përfunduar studimet e larta në fushat e Ekonomisë dhe Drejtësisë. Në vitin 2013 ka përfunduar kualifikimin profesional për Ekspert të Vlerësimit mbi Pasuritë e Paluajtshme pranë Universitetit Politeknik të Tiranës.

Ai gëzon një eksperiencë administrative rreth 16 vjeçare në fushën e kontrollit dhe auditimit nga të cilat rreth 10 vite pranë administratës tatimore dhe 6 vite në veprimtarinë audituese pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Gjatë karrierës së tij profesionale ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, mbi çështjet fiskale, luftës kundër pastrimit të parave, parandalimit të konfliktit të interesit si dhe në një sërë konferencash ndërkombëtare me institucionet homologe të KLSH.

Z. Xhaferaj është angazhuar edhe në rolin e trainerit për administratën tatimore sa i përket zbatimit të legjislacionit tatimor.

Prej vitit 2018 ka vijuar në funksionin e Kryeaudituesit në disa prej Departamenteve të KLSH si, Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit, Departamenti i Institucioneve Qendrore, Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja në të cilin ka mbuluar për një periudhë kohe dhe pozicionin e drejtuesit të këtij departamenti.

Aktualisht vijon në funksionin Kryeauditues në Departamentin e Auditimit të Performancës.

Z.Xhaferaj është njohës shumë i mirë i gjuhës angleze dhe italiane.